



Titulli i projektit

Krijimi i Linjës Ujore Turistike në Liqenin e Fierzës

Tipi i projektit

Infrastrukturor/Turistik

Vendndodhja e projektit

Liqeni i Fierzës

Buxheti i paravlerësuar

220,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Turizmi është prioriteti kryesor i Strategjisë Rajonale të Zhvillimit të Qarkut Kukës dhe Liqeni i Fierzës është një ndër zonat prioritare për zhvillimin e turizmit.

Liqeni artificial i Fierzës, me një bosht gjatësor prej 70 km, sipërfaqe prej 7 mijë hektarësh, thellësi deri 128 m dhe volum uji 2.7 miliard m³, është më i madhi në Shqipëri. Liqeni u krijua në vitin 1978, mbi Lumin Drin për HEC-in e Fierzës dhe për rregullimin e furnizimit me ujë të dy hidrocentraleve të tjerë të kaskadës së Drinit: Komanit dhe Vaut të Dejëës. Ai shërben edhe si nyje lidhëse mes Kukësit, Tropojës dhe Hasit. Ai është habitati i 13 llojeve të ndryshme peshqish, shumë lloje molusqesh, gaforresh dhe amfibësh. Udhëtimi me traget apo jaht në ujërat e tij është i magjishëm, pamjet që shpalosen befasisht në brigje janë mbresëlënëse dhe të paharrueshme. Disa prej bizneseve turistike në brigjet më të bukura ofrojnë pushim të këndshëm, ushqim të shijshëm tradicional dhe turizëm balnear në ujërat e ëmbla të liqenit.

Ky projekt, duke u bazuar tek oferta e zonës, synon jo vetëm zhvillimin e zonës si atraksion turistik, por edhe rritjen e ndjeshme ekonomike për banorët e zonave përreth. Njëpërmjet vënies në dispozicion të një anijeje, do të lehtësohet qarkullimi ujqor, si për banorët e zonës, ashtu edhe për vizitorët vendas e të huaj.

Aktualisht në Liqen operojnë dy tragete ekzistuese (me kapacitet rreth 30 persona), por që nuk janë shumë funksionale. Ato veprojnë vetëm për transport, si dhe në rastet kur prenohen paraprakisht. Ndaj ka lindur nevoja e pasjes së trageteve turistike, që të ofrojnë ture turistike nga Liqeni i Fierzës në Liqenin e Komanit. Këto tragete duhet të përmbushin kushtet bazë të qëndrimit dhe ushqimit.

Qëllimi/et specifik të projektit

Ky projekt ka për qëllim të shkurtojë distancat për zonat që ndodhen përgjatë brigjeve, të nxisë interesin e investitorëve vendas dhe të huaj për investime të ndryshme në këto zona, duke bërë të mundur zhvillimin turistik, ekonomik dhe social.

1. Objektivat specifike të projektit

OS1: Të kthejë Liqenin e Fierzës në atraksion turistik të shfrytëzueshëm

OS2: Të krijojë itinerare turistike

OS3: Të vendosë në shfrytëzim 4 pika pushimi përgjatë Liqenit të Fierzës

OS4: Të rrisë numrin e vizitorëve në Kukës



Rezultatet e pritshme dhe treguesit

- R1: Rritja e numrit të të punësuarve
- R2: Zhvillimi i transportit ujqor
- R3: Shfrytëzimi racional i pasurive natyrore
- R4: Mbështetje në ngritjen e bizneseve të vogla në zonat përgjatë Liqenit të Fierzës
- R5: Rritja e numrit të vizitorëve
- R5: Promovimi i zonës

Aktivitetet e projektit

1. Studimi i zonës nga specialistë të fushës dhe agjencitë turistike për përcaktimin e itinerareve
2. Përcaktimi i 4 zonave më të përshtatshme për zhvillimin turistik
3. Vendosja e kontakteve me njësinë përkatëse të qeverisjes vendore
4. Organizim tavolinash të rumbullakëta mbi objektet që do të ndërtohen në secilën pikë pushimi
5. Trajtime të ndryshme për shërbimet turistike
6. Blerjen e një anijeje për shëtitje turistike me kapacitet prej 50 personash dhe mundësi parkingu për biçikleta dhe motoçikleta
7. Promovimi i zonave turistike përgjatë Liqenit të Fierzës në web, fletëpalosje, guida, etj.

Projekti mendohet të zbatohet në një periudhë 2-vjeçare.

Maturimi i projektit

N/A

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Financuesit e projektit:
Nuk ka ende fonde të siguruar nga donatorët.
Projekti do të zbatohet nga:
- Agjencia e Zhvillimit Rajonal Kukës.
- Këshilli i Qarkut Kukës
- Bashkia Kukës

Kostot e projektit

Studimi i zonës nga specialistë të fushës dhe agjencitë turistike për përcaktimin e itinerareve 15,000€
Përcaktimi i 4 zonave më të përshtatshme për zhvillimin turistik 15,000€
Vendosja e kontakteve me njësinë përkatëse të qeverisjes vendore 5,000€
Organizim tavolinash të rumbullakëta mbi objektet që do të ndërtohen në secilën pikë pushimi 5,000€
Trajtime të ndryshme për shërbimet turistike 20,000€
Blerjen e një anijeje për shëtitje turistike me kapacitet prej 50 personash dhe mundësi parkingu për biçikleta dhe motoçikleta 140,000€
Promovimi i zonave turistike përgjatë Liqenit të Fierzës në web, fletëpalosje, guida, etj. 20,000€